

Broshurë,
3-mujori i katërt,
2023



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Tetor - Dhjetor 2023



Zhvillimi i qëndrueshëm është harmonizimi i zhvillimit ekonomik, dhe mbrojtja e mjedisit për të plotësuar nevojat e të sotmes, pa rrezikuar mundësitë që edhe brezat e ardhshëm t'i shfrytëzojnë këto kapacitete dhe t'i përmbushin nevojat e veta.





BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE

- Dhuroi dy automjete elektrike për Policinë Bashkiake të Sarandës. Kjo nismë shërben jo vetëm në forcimin e masave të sigurisë, por gjithashtu përputhet me angazhimin e qytetit në përmbushjen e synimeve ekologjike.



CREDINS BANK

- Alternativat mbi mbrojtjen e mjedisit, të cilat vijnë përmes programeve apo projekteve novatore si në rastin e Climathon, gjejnë gjithmonë mbështetje nga banka. Të udhëhequr nga 21 mentorë profesionistë si dhe nga vetë Credins Bank, të rinjtë, pjesë e këtij projekti, patën mundësi të fitojnë njohuri të vlefshme për realizimin e projekteve të tyre.



FIBANK ALBANIA

- Banka ka iniciuar një projekt për mbjelljen e pemëve, duke u zotuar se do të mbjellë një pemë për çdo anëtar të familjes që merr një kredi hipotekare nga kjo bankë. Në fazën e parë, zhvilluar në bashkëpunim me World Vision dhe Bashkinë Dibër, u bë mbjellja e 200 pemëve bliri në Rabdisht, një zonë atraktive pjesë e "100 fshatrave turistike" në Shqipëri. Kjo nismë, gjithashtu, demonstroi përgjegjësinë sociale të korporatës që synon të ndikojë pozitivisht në mjedis dhe të përmirësojë cilësinë e përgjithshme të jetës.



INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

- Në Ditën Botërore të Ushqimit më 16 tetor, banka theksoi temën e këtij viti: "Uji është jetë, uji është ushqim. Mos lini askënd pas!" Banka përcolli mesazhe përmes kartolinave të dedikuara të shpërndara për të gjithë stafin, duke nxitur ndërgjegjësimin për rolin kritik të ujit në ruajtjen e jetës në Tokë.





BANKA OTP ALBANIA

- ▶ Disa çanta u pikturuan me bojëra speciale nga fëmijët e stafit të bankës. Të ardhurat nga shitja e tyre shkuan për mbjelljen e pemëve në qytetin e Shkodrës. Fëmijët dhe stafi morën pjesë aktive në këtë nismë, duke kontribuar jo vetëm në mbjelljen e pemëve, por edhe në mesazhin që përcjell, për t'u kujdesur më shumë për mjedisin në të cilin jetojmë.



PROCREDIT BANK ALBANIA

- ▶ Ishte pjesë aktive në Panairin e Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së Gjelbër në Pallatin e Kongreseve në datat 5-6 tetor 2023. Gjatë panelit të diskutimit, përfaqësuesi i ProCredit Bank theksoi avantazhet e investimit në panele diellore dhe efikasitetin e energjisë, duke u fokusuar veçanërisht në programin GEFF të BERZH-it.
- ▶ Banka mori pjesë në Konferencën “Avokimi për Vetë-prodhuesit e Energjisë Diellore” në Universitetin Fan S. Noli në Korçë. Përfaqësuesi i bankës theksoi rëndësinë e investimeve individuale, duke u mundësuar në uljen e faturave të energjisë, të përmirësojnë kushtet e jetesës dhe të kontribuojnë pozitivisht në mjedis.
- ▶ Mori pjesë në edicionin e katërt të panairit Build & Live Smart Expo 2023, në panelin “Mbështetja e zhvillimeve urbane përmes financimit të gjelbër”. Përfaqësuesi nga Njësia e Mjedisit të bankës ndau njohuri mbi investimet efikase të mbështetura nga ProCredit Bank, duke theksuar mundësitë e disponueshme në kuadër të GEFF.



MARRËVESHJE PËR PROJEKTET E GJELBRA - GEFF

Procredit Bank dhe **Union Bank** kanë nënshkruar me BERZH marrëveshjen për hua me qëllim rritjen e kapacitetit huadhënës për projektet e gjelbra në sektorin rezidencial dhe janë pjesë e programit GEFF - Green Economy Financing Facility i cili mbështet investimet në teknologjitë e gjelbra me ecuri të lartë, materiale dhe zgjidhje për ndërtesat e banimit në pronësi private. Nëpërmjet kësaj huaje, bankat do të mbështesin investimet me efikasitet në energji dhe të nxisin kapacitetin huadhënës për projektet e gjelbra, në mënyrë që të promovojë objektivat e saj sociale dhe mjedisore. Krahas kësaj, klientët do të përfitojnë grand deri në 20% të vlerës së kredisë pas përfundimit të suksesshëm të investimit.





BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE

- Mëbshteti Automotive Fair Albania II në muajin Tetor, ku, përgjatë 4 ditëve në Pallatin e Kongreseve, sheshin “Nënë Tereza” dhe sheshin “Italia”, u zhvilluan një sërë aktivitetesh argëtuese për fëmijë e të rritur.

BANKA KOMBËTARE TREGTARE (BKT)

- Në mbështetje të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të kushteve në institucionet arsimore, banka ka dhuruar sete kompjuterësh, fotokopjuese dhe printerë për shkollat në Tiranë, Korçë dhe Librazhd.
- Kontribuon në sigurinë kombëtare duke financuar blerjen e licencave për platformën SOCRadar, duke ndihmuar në krijimin e një mjedis më të sigurt për operatorët e infrastrukturës kritike në Shqipëri.

CREDINS BANK

- Ishte pjesë e Panairit të Punës “Expo 2023” - një panair që mbart mesazhin e mundësisë së punësimit për gratë dhe vajzat, njëherazi edhe kauzën e rëndësishme të integritimit, për t'i dhënë çdokujt mundësinë e barazisë në punësim, zhvillim profesional, etj.
- Java Ndërkombëtare e Sipërmarrjes ishte një event strategjik që synoi transformimin e kulturës së biznesit drejt digjitalizimit të shërbimeve dhe produkteve. Mes 35 partnerëve të rëndësishëm të fushës së politikës, ekonomisë, shoqërisë civile dhe ekspertëve të teknologjisë, banka ishte një nga aktorët kryesorë në vend që vazhdon të japë kontributin e saj, mbi zhvillimin e politikave dhe strategjive në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë.
- Firmosja e marrëveshjes me Universitetin e Tiranës është një nga marrëveshjet më të rëndësishme për bankën, e cila u mundëson të rinjve të integrohen në sektorin bankar, përmes punësimit, intership-eve, trajnimeve, etj.






INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

- ▶ Për sezonin e Krishtlindjeve, mori pjesë në nismën “Krishtlindjet 2023 në Solidaritet”, organizuar nga Ambasada Italiane. Duke kontribuar në mesazhin pozitiv të paqes dhe solidaritetit, banka dhuroi 20 karta Spar me vlerë 50 euro secila, të dizajnuara me logon e saj dhe një kartolinë të punuar posaçërisht nga artistja shqiptare Ledia Kostandini.
- ▶ Banka u shpall finaliste në kategorinë “SDG International Business” gjatë edicionit të parë të “SDG Business Pioneers Awards 2023” në Shqipëri. Kjo mirënjohje thekson përpjekjet e bankës në promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) në vend.
- ▶ Në vazhdim të angazhimit të saj për edukimin financiar, banka po zhvillon konkursin “S.A.V.E. Ambassadors” në bashkëpunim me FLITIN – Rrjeti Ndërkombëtar i Edukimit Financiar. Këtë vit marrin pjesë 22 klasa nga shkollat e mesme në Tiranë, dhe klasa fituese që do të caktohet si “S.A.V.E. Ambassador”, do të përfaqësojë vendin tonë në konkursin ndërkombëtar, më datë 31 Janar 2024.



PROCREDIT BANK

- ▶ Si një prej nënshkruesve të Parimeve të Fuqizimit të Grave (WEPs), mori pjesë në UN Women’s Albania’s Expo 2023. Fokusi parësor ishte tek gratë sipërmarrëse, duke theksuar mundësitë e ofruara nga banka përmes Paketës Gratë në Biznes.
- ▶ Mori pjesë në vlerësimin e projekteve të prezantuara gjatë konkursit “Techstars_ Startup Weekend” në Universitetin Luigj Gurakuqi. Përfaqësuesja e bankës shërbeu si anëtare e jurisë, duke shprehur mbështetjen e ProCredit Bank për projektet inovative të zhvilluara nga studentët e universitetit që synojnë të krijojnë biznese të reja në Shkodër.
- ▶ Banka nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, për të ofruar





programe praktike dhe punësimi për studentët Bachelor dhe Master tëkëtij fakulteti.

RAIFFEISEN BANK

- Cyberwise - ishte projekti më i fundit ku banka bashkëpunoi me Qendrën IMPAKT. 300 nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në Tiranë janë pjesë e një rrugëtimi edukativ mbi sportin kibernetik. Gjatë 20 orëve të trajnimit, në 10 seminare, u trajtuan temat kryesore si mbrojtja nga sulmet kibernetike, përgjegjshmëria, menaxhimi i privatësisë në internet dhe ndërgjegjësimi për problemet e rrjeteve sociale.
- Për të tretën herë radhazi, në bashkëpunim me Institutin e Politikave, banka mbështeti projektin “Njih paratë e tua 3”, i cili ka në fokus edukimin financiar të të rinjve. Këtë vit janë informuar dhe trajnuar 249 gjimnazistë në 4 shkolla të mesme të Tiranës.



UNION BANK

- Mori pjesë aktive në Panairin “Agrotech Expo 2023”, duke përforcuar angazhimin e saj për rritjen e sektorit agro. Në stendën e bankës u prezantuan zgjidhje të përshtatura financimi për të gjithë segmentin e agrobiznesit.
- lu bashkua panairit “Tirana Tech Open”, organizuar nga Expocity Albania, ku znj. Flutura Veipi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive dhe drejtues të tjerë u angazhuan në diskutime mbi tendencat e teknologjisë. Panairi ofroi një mundësi për të eksploruar projektet inovative të Union Bank, duke përfshirë shërbimin UB Online.
- Duke demonstruar përkushtimin tonë ndaj arsimit, banka bashkëpunoi me Agjencinë Rinore në Bashkinë e Tiranës për të dhuruar 10 bursa studentore, duke nënvizuar fokusin në mbështetjen e të rinjve përmes nismave si “Karta Studenti 2 në 1” dhe promovimi i edukimit financiar.





BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE

- ▶ Banka, në cilësinë e Sponsorit Gold, mbështeti koncertin e parë recital në Tiranë të artistes Elsa Lila, i titulluar "Finalmente Elsa".
- ▶ Duke përqafuar moton "ABI Loves ART", banka mundësoi koncertin në violinë dhe piano nga artistët e mirënjohur Tedi Papavrami dhe Maki Okada. Me të ardhurat e mbledhura prej këtij projekti do të financohet bursa e studimit 2024 jashtë vendit për Marla Hoxha, një studente e dalluar e violinës e përzgjedhur nga Tedi Papavrami përmes një konkursi të zhvilluar në Liceun Artistik Jordan Misja.
- ▶ Banka mbështeti projektin në ndihmë të fëmijëve në familjet e marginalizuara në Korçë, pjesë e ankandit "Rrathë Dhurues", organizuar nga Partners Albania në mbështetje të kauzave të ndryshme sociale.



BANKA KOMBËTARE TREGTARE (BKT)

- ▶ Banka është anëtare e organizatës së Kombeve të Bashkuara "Global Compact" si edhe firmëtare e parimeve të Fuqizimit të Grave dhe përtë disatin vitradhazi i bashkohet nismës "16 ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave" të UN Women in Albania. Banka ndau në rrjetet e saj sociale, si edhe rrjetin e ATM-ve, mesazhe ndërgjegjësimi si edhe organizoi një takim me Fondacionin Vodafone Albania ku u diskutua rreth aplikacionit Bright Sky, një aplikacion falas që ofron mbështetje dhe informacion për këdo që mund të jetë në një marrëdhënie abuzive ose për ata njerëz që njohin dikë në një marrëdhënie të tillë.
- ▶ Punonjësit e bankës mbledhën dhe dhuruan vullnetarisht produkte të shportës, por edhe lodra dhe veshje. Në Tiranë 100 pakot e krijuara u shpërndanë për familjet në vështirësi ekonomike nga Kryqi i Kuq, Dega Tiranë, ndërsa në rrethe pakot u shpërndanë nga vetë stafi. Gjithashtu, banka organizoi një event festiv me muzikë e dhurata për fëmijët e familjeve në vështirësi ekonomike në qytetin e Delvinës.






- ▶ Banka mbështeti në rinovimin e shkollës së parë në gjuhën shqipe për zonën e veriut në fshatin Iballë, në kuadër të 120 vjetorit të hapjes së saj. Shkolla është njëherësh një prej katër shkollave të para në gjuhën shqipe në të gjithë vendin.
- ▶ Të verbër, por të etur për të lexuar - është nismë e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë e mbështetur nga BKT, duke financuar krijimin e librave audio që iu dhuruan Bibliotekës Kombëtare të të Verbërve.



CREDINS BANK

- ▶ Garo /Mbështet si Maratonomak DSA-në: një nga aktivitetet sportive që mbarti një mision të veçantë, mbështetjen e fëmijëve me sindromën Down. Ky aktivitet i cili, ishte pjesë edhe e Martonës së Tiranës, u mundësua nga banka.
- ▶ U nderua me çmimin prestigjioz "SDG Business Pioneer Albania 2023": Ky çmim i cili, jepet për herë të parë nga UNDP, ishte shpërblimi më i mirë për punën e shkëlqyer që banka ka bërë për komunitetin duke kontribuar maksimalisht në çdo fushë si mjedisi, arsimi, sporti, teknologjia, etj., konform 17 objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- ▶ "Sven Vath", "Finalmente Elsa", "3 Tenorët", ekspozita e piktorit Mikail Papuciu ishin vetëm disa nga eventet artistike të mundësuar nga banka, të cilat pasuruan jetën kulturore të vendit dhe erdhën si argëtim për të gjithë shqiptarët.
- ▶ Me rastin e festave të fund vitit, nën kujdesin e plotë të punonjësve të bankës, u organizuan aktivitete festive për fëmijët jetim, në bashkëpunim me Kryqin të Kuq si dhe shtëpinë e të moshuarve në qytetin e Fierit.



FIBANK ALBANIA

- ▶ Urimet për një vit të ri u përcollën edhe me lajtmotivin e vitit 2023, që ishte projekti i rëndësishëm CSR # tjetër herë me vajzë.





Banka ka mbështetur ndër vite fondacionin "Mother & Child", dhe në mënyrë të veçantë këtë vit, projektin për lëvizjen kundër abortit me bazë gjinore. Thelbi i mesazhit të bankës është: Le të mirëpresim çdo fëmijë, vajzë apo djalë me gëzim dhe falënderim!

- ▶ Dhuro një buzëqeshje! Dëshira të bëra realitet! Staf i bankës mbështeti World Vision Albania për organizimin e një feste për 30 fëmijë nga familjet në nevojë në zonën e Bathores dhe Kamzës.

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

- ▶ Çdo tetor, banka i bashkohet fushatës sensibilizuese për diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit. Të gjithë kolegët morën material informues të përgatitur nga kompania "Wellness Albania Clinic", i cili përfshin disa të dhëna dhe informacione të dobishme për kancerin e gjirit, ekzaminimet e nevojshme periodike, si dhe simptomat dhe faktorët e rrezikut që ndikojnë në këtë sëmundje.

Banka ofroi një fjongo rozë 3D në një pankartë kushtuar fushatës ndërgjegjëse për kancerin e gjirit në hyrje të degës kryesore pranë ambienteve të Zyrës Qendrore. Çdokush ishte i lirë t'i bashkohej fushatës duke bërë fotografi individuale ose në grup, të cilat mund t'i postonin në rrjetet e tyre sociale për të përhapur mesazhin në një audiencë më të gjerë gjatë gjithë vitit.

- ▶ 16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore - Fushata filloi më 25 nëntor dhe përfundoi më 10 dhjetor, Ditën e të Drejtave të Njeriut, duke treguar se dhuna ndaj grave është shkelja më e përhapur e të drejtave të njeriut në mbarë botën. Si çdo vit, banka iu bashkua fushatës për rritjen e ndërgjegjësimit të brendshëm dhe të jashtëm duke dërguar disa buletine për të gjithë stafin, postime në rrjetet sociale dhe nëpërmjet buletineve në ekranet e ATM-ve. Nuk ka #Asnjë justifikim për dhunën ndaj grave dhe vajzave!
- ▶ Gjatë sezonit festiv, banka përqafoi fushatën e kartolinave të Fondacionit Down Syndrome Albania. Fondet e krijuara nga shitja e kartolinave ndihmojnë Fondacionin DSA që të ofrojë shërbime terapeutike për fëmijët më në nevojë që frekuentojnë qendrën e shërbimit "PRO PAK". Në faqen e fundit të kartolinave është një kod QR (i cili mund të skanohet përmes celularit), ose adresa online që ju ndihmon të dhuroni për shërbimet terapeutike gjatë vitit. Nëpërmjet këtij gjesti, vetëm me një kartolinë mund të trefishojmë kontributin: atë të bankës, kontributin e stafit dhe kontributin e marrësit të kartolinës (në rast se ai/ajo dëshiron të dhurojë për të ndihmuar fëmijët).
- ▶ Në muajin nëntor banka organizoi iniciativën e dytë të Dhurimit Vullnetar të Gjakut për vitin 2023 në degën e rrugës Barrikada dhe në ambientet e zyrës qendrore.

BANKA OTP ALBANIA

- ▶ Edhe një herë, familja OTP tregon dashamirësi duke adresuar një nevojë kritike. Kutitë e gjelbra të dhurimeve u vendosën pranë



 **INTESA SANPAOLO BANK**
Albania





ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme. Në bashkëpunim me World Vision, të gjitha donacionet u paketuan dhe u shpërndanë në 11 familje të ndryshme.

- ▶ Fëmijët e stafit kontribuuan në një ekspozitë me pikturat e tyre. Të ardhurat nga shitja mbështesin kurse arti për fëmijët e “Qytetit të Fëmijëve në Korçë”.
- ▶ Të nxitur nga një dëshirë e fortë për të ndarë njohuritë përmes librave, Green Hearts ndërmerr një iniciativë të veçantë për të dhuruar libra për fëmijë. Stafi i bankës dhuroi mbi 200 libra të zhanreve të ndryshme, duke u ofruar nxënësve të shkollave 9-vjeçare të Gramshit mundësinë për të zgjeruar horizontet e tyre me një mik si një libër.
- ▶ Më 5 dhjetor 2023, e cila shënon Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, Kryqi i Kuq Shqiptar, nën moton “Vullnetarizmi na bashkon të gjithëve! Ne jemi forca e Mirësisë!” organizoi një mbrëmje bamirësie. Morën pjesë të ftuar të nderuar, përfshirë trupin e akredituar diplomatik në Shqipëri, gazetarë dhe personalitete të kulturës. Mbrëmja paraqiti një ekspozitë me piktura të krijuara nga vullnetarët, me të ardhurat për të ndihmuar fëmijët në nevojë që nuk janë në gjendje të flasin, dëgjojnë ose shohin. Banka bashkoi vullnetarisht forcat për të kontribuar në nismën humanitare të Kryqit të Kuq.
- ▶ Të nxitur nga dëshira për të sjellë gëzim në zemrën e një fëmije këtë sezon festiv, punonjësit e bankës kontribuuan kolektivisht dhe individualisht në blerjen e dhuratave të lodrave për fëmijët në nevojë. Në vazhden e përpjekjeve të World Vision, veshjet e mbledhura gjatë festave iu shpërndanë fëmijëve në nevojë në Përrenjas.

PROCREDIT BANK

- ▶ *#JoJustifikim për dhunën me bazë gjinore.* Banka, si një nga kompanitë nënshkruese të WEPs (Parimet e Fuqizimit të Grave) i është bashkuar fushatës 16-ditore të UN Women Albania. Në kuadër të kësaj fushate, banka organizoi një leksion të hapur në Fakultetin e Shkencave Sociale, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për këtë çështje tek brezat e rinj.
- ▶ Banka iu bashkua fushatës sensibilizuese Movelt4SOS, e cila mundësoi mbledhjen e fondeve për Fshatrat e Fëmijëve SOS Shqipëri nga tetori deri në dhjetor.

RAIFFEISEN BANK

- ▶ Banka përfundoi me sukses edicionin e 6-të të Key Academy, një program i përshtatur për studentët e teknologjisë dhe me profile teknike. Nëpërmjet një mini-Innovation Bootcamp që përfshin gjashtë javë intensive, pjesëmarrësit eksploruan fushat kryesore të teknologjisë, duke përfshirë Menaxhimin Projektive Agile, Arkitekturën Moderne të Softuerit, Produktet Financiare Digjitale, Të Dhënat, Cloud dhe Inxhinieri DevOps.






- ▶ Banka kontribuoi në ngritjen e Qendrës Rinore Multifunkionale në Petrelë, duke ofruar orendi dhe pajisje. Kjo qendër parashikohet të jetë një qendër edukuese dhe mbështetëse jo vetëm për të rinjtë por edhe për të gjithë komunitetin.
- ▶ Projekti Colors of Hope, pjesë e nismës “Ne kujdesemi me zemrat tona”, shfaq talentin autentik të fëmijëve përmes një ekspozite. Qëllimi kryesor është rritja e ndërgjegjësimit dhe mbështetja për shtresat në nevojë, veçanërisht fuqizimi dhe ndihma e fëmijëve me nevoja të veçanta, duke përfshirë ata në spektrin e autizmit. Të ardhurat nga blerjet e pikturave do të kontribuojnë në trajtimin e këtyre fëmijëve.



TIRANA BANK

- ▶ Në Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve, përfaqësuesit e bankës shtruan një drekë pranë mensës të Qendrës Sociale të Kryqit të Kuq.
- ▶ Sponsorizimi i laboratorit të IT-së në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit qëndron si simbol i përkushtimit të bankës për të ushqyer gjeneratën e ardhshme të pionierëve digjitalë. Znj. Elinda Meçe, Dekane e Fakultetit, shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të bankës në përgatitjen e brezit të ri për tregun e punës. Në një takim me studentët, Z. Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Tirana Bank, i ftoi ata të marrin pjesë në leksionet e hapura dhe në programin Tirana Bank Students Hub, duke theksuar mundësitë e praktikës në bankë.
- ▶ Nisma për krijimin e udhëzuesve për fëmijët dhe të rinjtë për kështjellat e Tiranës synon të nxisë njohjen e këtyre monumenteve si trashëgimi kulturore dhe atraksione turistike. Këto guida, të disponueshme në formate fizike (të printuara) dhe digjitale (udhëzues për adoleshentët dhe fëmijët), lehtësojnë ecjen brenda dhe jashtë perimetrit të qytetit të Tiranës.
- ▶ Prania e bankës pranë fëmijëve në Shërbimin Special Nr. 2 në QSUT, ku u shpërndanë dhurata, nënvizon angazhimin e bankës për përgjegjësinë sociale dhe mirëqenien e komunitetit.



UNION BANK

- ▶ In support of Pink October, the breast cancer awareness month, the bank organized an open meeting for staff with oncologist Dr. Alketa Curri.
- ▶ Continuing its commitment to education, the bank sponsors for the second year the “Build the Future” contest, part of the “Build & Live Smart Expo 2023” Fair by Expocity Albania, encouraging young students of Architecture and Urbanism from the University of Tirana, University of Prishtina, and University of Tetova to enhance their knowledge and contribute to their respective fields.





UBA BANK

- ▶ Në kuadër të nismës “Dita e Solidaritetit dhe Aktivizmit Social në Shqipëri”, banka mirëpriti nxënësit e gjimnazit “Ismail Qemali”. Prof. Asc. Dr. Orfea Dhuci, Drejtor i Përgjithshëm i UBA Bank, ndau me studentët njohuri mbi zhvillimin e sektorit bankar.
- ▶ Banka mori pjesë aktive në ankandin “Rathet dhurues” organizuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Kontributi shkoi në ngritjen e një klase burimore për nxënësit me nevoja të veçanta në Shupenzë, Bulqizë, duke synuar krijimin e një mjedisi të favorshëm mësimor me module dhe materiale didaktike të përshtatshme.
- ▶ Në një frymë festive, banka shpërndau dhuratat e festave, duke u siguruar që çdo fëmijë i stafit të bankës të marrë një kupon dhuratë. Aktiviteti përfshinte një vizitë në degën qendrore, ku fëmijët shprehën krijimtarinë e tyre përmes pikturës, duke treguar përkushtimin e bankës për të nxitur një atmosferë pozitive në komunitet.

MARATONA E TIRANËS 2023

Është traditë tashmë që stafi i bankave merr pjesë në nismën e Maratonës së Tiranës. Ky ishte edicioni i 7-të i Maratonës së Tiranës, i cili u organizua më 22 tetor dhe konsiderohet si veprimtaria më e madhe sportive në qytet (“Qyteti Evropian i Sportit”). Organizatorë të këtij aktiviteti janë: Bashkia e Tiranës, Fondacioni EDS dhe Federata Shqiptare e Atletikës.

Bankat pjesëmarrëse: Fibank Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Procredit Bank, Union Bank.

